

Raport Muaji Korrik 2021

Informacion bazë

Administrimi i Fondit	Shoqëria Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	Euro
Datë Lancimi	22 Nentor 2012
Vlera fillestare e kuotës	100
Shuma fillestare minimale	250
Shuma minimale pasuese	50
Komision në hyrje	0.00%
Komision në dalje	0.00%
Komision Administrimi në vit	1.50%
Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta	Referojuni informacionit ne deget e RBAL

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të mund t'i sigurojë investitorit një kthim nga investimi në përputhje me një menaxhim të kujdesshëm të portofolit duke ruajtur nivelin e kapitalit dhe likuiditetit të nevojshëm.


Nje pjese e rendesishme e aseteteve te fondit mund te investohen ne bono dhe obligacione thesari te Qeverise se Republikes se Shqiperise, te emetuara ne monedhen euro. Megjithate, frekuenca e emetimeve ne euro nga Qeveria e Republikes se Shqiperise do te percaktoje shkallen ne te cilen Fondi do te investoje ne keto lloj instrumentash.

Fondi eshte i pershtatshem per individet dhe subjekte juridike te cilet mendojne se objektivi i investimit i Fondit perputhet me kerkesat dhe pritshmerite e tyre.

Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

Rrezik i lartë
Përfitimet tipike më të larta



Fondi Raiffeisen Invest Euro është në kategorinë e tretë të Profilit të Rrezikut dhe Përfitimit

Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik.

Ky tregues ka për qëllim tju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 31 Korrik 2021



Vlero Neto e Aseteve	69,562,072
Numri I Investitoreve	2,885
Cmimi I Kuotes	118.6245
*Kthimi Vjetor nga Investimi (31.07.2020 – 31.07.2021)	3.39%

*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e Portofolit të investimeve më 31 Korrik 2021

Portofoli i fondit Euro është ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga balancimi i kategorive të ndryshme të investimeve në bono dhe obligacioneve qeveritare dhe të korporatave. Kjo bëhet me qëllim për të diversifikuar portofolin dhe ulur rrezikun që vjen nga ekspozimi i gjere ndaj pak instrumenteve.

Përqindja e alokimit të aseteve bëhet në përputhje me politikën e investimit dhe kriterëve të specifikuar në prospektin e fondit. Shpërndarja e aseteve mund të jetë jashtë objektivit të përcaktuar për shkak të ndryshimeve të kushteve të tregut. Asetet e Fondit janë të investuara në instrumente financiare që i përkasin emetuesve që performojnë në industri të ndryshme të ekonomisë duke bërë të mundur rritjen e diversifikimit të portofolit.




Obligacionet të quajtura “dytësore” (ose me termin financiar subordinated) janë përafërsisht 6.05% e portofolit, në fund të Korrikut. Duke iu referuar strukturës së portofolit të investimeve të fondit më 31 Korrik 2021, përqindja e aseteve të fondit e investuar në Obligacione Shtetërore qëndron në 40.8% të aseteve, dhe 37% e tyre i përkasin obligacioneve të Qeverisë Shqiptare, të tregtuar në tregje ndërkombetare. Fondi mund të balancojë ekspozimin ndaj instrumenteve të ndryshme në varësi të kushteve të tregut për të arritur objektivat e tij afatgjatë.

Asetet e fondit të investuara në obligacione të korporatave me vlerësime të larte jane 28.1% e asetëve dhe investimet në Fondet e Investimeve janë 28% e totalit të aktiveve. Keto fonde investimi gjithashtu kanë në fokus investime në tregun e obligacioneve. Likuiditeti i mbajtur ne cash dhe depozita qëndron në nivelin 3.1% e totalit të asetëve te fondit. Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin 69.562 milion EUR në fund të muajit Korrik.


Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës gjate muajit Korrik

Gjatë muajit Korrik vlera e kuotes se fondit Euro ka pesuar rritje me **0.40%** në krahasim me muajin e kaluar, duke regjistruar një nga performancat më të mira mujore për këtë vit. Yield-et e obligacioneve u përballen me një trend rënës gjatë gjithë muajit, duke arritur përsëri nivele shumë të ulëta. Kjo ka ndihmuar në rivlerësimin pozitiv të portofolit të investimeve dhe përgjithësisht të gjitha investimet kanë shënuar fitime. Sidoqofte, fondi Euro eshte fokusuar kryesisht në investime afatmesme, në mënyrë që të jetë i kujdesshëm ndaj rrezikut të normave te interesit.

Kthimi neto vjetor rezultoi në nivelin 3.39% më 31 Korrik 2021. Edhe pse u ndikua nga pandemia pergjate vitit të kaluar, fondi ka arritur përsëri një kthim vjetor pozitiv dhe të kënaqshëm duke rikuperuar nje pjese te mire te humbjeve te shkaktuara gjate 3muajorit te pare te vitit 2020.



Kthimi Neto i fondit Raiffeisen Invest Euro per çdo vit



Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut dhe çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Luhatshmëria është pjesë e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur.

Investitorët e fondit Raiffeisen Invest Euro dhe te gjithe fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfutur nje kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond te nxitur nga situa ta jo e zakonshme e krijuar nga pandemia globale, sepse ne kete menyre nuk do te rrezikojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Zhvillimet dhe informacion mbi ecurinë e tregjeve financiare gjate muajit Korrik

Ndërsa varianti Delta ka sjellë shqetësime në treg, pasi numri i rasteve është rritur në të gjithë botën, zona e euros duket se është drejt një rimëkëmbjeje pothuajse të plotë. Ekonomia më e fuqishme e rajonit, Gjermania, pritet të arrijë nivelin e saj të aktivitetit para-pandemik gjatë këtij viti dhe vendet e jugut që varen nga turizmi, ka të ngjarë ta arrijnë këtë vitin e ardhshëm. Duket e pashmangshme që varianti Delta do të çojë në një distancim vullnetar shoqëror ose vetë-izolim dhe ndoshta kufizime të caktuara gjatë dimrit, por mendohet se nuk do ta pengojë rimëkëmbjen.

Inflacioni mbetet i lartë dhe ndoshta do të rritet më shumë nga sa pritej, në muajt e ardhshëm, për shkak të rritjes së kostove të inputeve. Të dhënat gjatë Korrikut treguan se shitjet me pakicë mbetën konstante në SHBA, por ndjesia e konsumatorëve papritur ra në nivelin më të ulët të pesë muajve të fundit, duke arritur në 80.8 nga 85.5, gjë që provon mëtej se rritja e çmimeve po rëndon mbi shpenzimet reale.

Pavarësisht shqetësimeve në rritje për inflacionin, ndjesia në tregun e obligacioneve duket të jetë pozitive. Yield-et afatgjata në tregjet e zhvilluara vazhduan rënien në Korrik, ashtu si dhe në Qershor, ndërsa çmimet u rritën. Kjo mund të vijë për shkak të përforcimit nga përfaqësuesit e bankave qendrore se rritjet më të fundit të inflacionit do të jenë kalimtare.

Rezerva Federale hodhi një hap të vogël drejt zvogëlimit përfundimtar të blerjes së aseteve, duke ndryshuar gjuhën në deklaratën e lëshuar gjatë Korrikut. Njoftimi pritet në Gusht ose Shtator, por ritmi më i ulët i blerjeve, me gjasa, nuk do të nisë deri në fillim të vitit 2022. Megjithatë, u theksua se rritja e normave të interesit afatshkurtra mund të ndodhë më herët nga sa ishte parashikuar.

Banka Qendrore Europiane (BQE), nga ana tjetër, vazhdoi me rishikimin e strategjisë së saj duke përdorur një gjuhë që ndoshta ishte më e butë nga sa pritej dhe që sugjeron se rritjet e normave të interesit janë ende vite larg. Banka Qendrore, për momentin, dëshiron të lërë normat në nivelet aktuale ose më të ulëta, derisa norma e inflacionit të ketë arritur në mënyrë të qëndrueshme dhe të qartë, para përfundimit të horizontit të parashikuar, kufirin prej 2%. Kjo mund të nënkuptojë një periudhë kalimtare në të cilën inflacioni është mesatarisht mbi objektivin. BQE ka të ngjarë të rrisë programin e saj standard të blerjes së aseteve kur blerjet e emergjencës të përfundojnë, Marsin e ardhshëm dhe të lërë normën e e saj të depozitave në -0.5% deri përtej vitit 2025.

OPEC + arriti t'i kapërcejë tensionet dhe arriti një marrëveshje për të rritur prodhimin. Kjo shkaktoi një rënie të çmimeve të naftës, por së shpejti ato iu rikthyen niveleve të mëparshme, duke e përfunduar kështu muajin me vlera të larta.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjerë numerikë janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analizë të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit.

Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha., në faqen zyrtare www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.